



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 132

6 gusht

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 8276 datë 24.7.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 5815
Dekret nr. 8277 datë 29.7.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 5815
Dekret nr. 8278 datë 29.7.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 5816
Dekret nr. 8281 datë 1.8.2013	Për emërim gjyqtari..... 5816
Dekret nr. 8282 datë 1.8.2013	Për emërim gjyqtari..... 5817
Dekret nr. 8283 datë 2.8.2013	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar komune, komuna Rrethina, qarku Shkodër..... 5817
Vendim i KM nr. 610, datë 24.7.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar..... 5818
Vendim i KM nr. 611, datë 24.7.2013	Për një shtesë në vendimin nr.590, datë 5.9.2007 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e banesave të personaliteteve të larta shtetërore të vendit, të selive, rezidencave dhe objekteve të tjera shtetërore, që do të ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë”..... 5820
Vendim i KM nr. 613, datë 24.7.2013	Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “ROT” (rehabilitim, operim, transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Kurum International” sh.a, për rehabilitimin e rafinerisë së Cërrikut, rrethi Elbasan..... 5820

Vendim i KM nr. 614, datë 24.7.2013	Për dhënie ndihme financiare familjes së të ndjerit Selman Hajredin Lena, ish-punonjës policie, rënë në krye të detyrës.....	5842
Vendim i KM nr. 615, datë 24.7.2013	Për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të inspektor Preng Llesh Lleshaj, i plagosur në krye të detyrës.....	5843
Vendim i KM nr. 616, datë 24.7.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Besart Mataj.....	5843
Vendim i KM nr. 617, datë 24.7.2013	Për një ndryshim në vendimin nr.997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar	5844
Vendim i KM nr. 618, datë 24.7.2013	Për një ndryshim në vendimin nr.455, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për pagat dhe shtesat mbi pagë të punonjësve të shërbimit pyjor”, të ndryshuar.....	5844
Vendim i KM nr. 619, datë 24.7.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 438, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”, të ndryshuar.....	5845

DEKRET
Nr. 8276, datë 24.7.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Suvada Idriz Zalli (Hamidoviç)
2. Bujar Ibrahim Lubishtani
3. Skender Musa Musa
4. Alpaj Mustafa Jashar
5. Armelle Odile Fabienne Louis Paul José Vioujard (Gjoni)
6. Vath Xhemal Masha
7. Lendita Muharem Kanushaj (Rama)
8. Ersin Mustafa Gökçek
9. Inan Cafer Eren
10. Shenur Ibrahim Kamberi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8277, datë 29.7.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Musa Imer Ahmeti
2. Altan Ömer Aldemir



3. Eleonora Lek Dulaj (Lekaj)
4. Gökhan Ahmet Şahutoğlu
5. Xhemajli Sali Muçaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8278, datë 29.7.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:
Alban Sazan Kelmendi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8281, datë 1.8.2013

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 70 pika 5 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe të nenit 113 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Mariana Velçani emërohet gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8282, datë 1.8.2013

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 70 pika 5 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe të nenit 113 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Ahmet Jangulli emërohet gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8283, datë 2.8.2013

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR KOMUNE, KOMUNA
RRETHINA, QARKU SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 92 germa “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10 paragrafi 3 të ligjit nr. 10 019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

Caktimin e datës 1 shtator 2013, për zhvillimin e zgjedhjeve për kryetar të komunës Rrethina, qarku Shkodër.



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Bujar Nishani

VENDIM

Nr. 610, datë 24.7.2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 717, DATË 23.6.2009 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË
INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Lidhja nr. I “Nivelet e pagës bazë për klasë në administratën e Presidentit, Kuvendit, në Kryeministri, institucione të pavarura, aparatet e ministrive të linjës, institucione qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr. II “Nivelet e pagës bazë për klasë në institucionet rajonale dhe vendore”, e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Pas pikës 19 shtohet pika 19/1 me këtë përmbajtje:

“19/1 Për një periudhë transitorë, punonjësit aktualë, që përfshihen në “Projekti hidrik dhe kanalizimet e Tiranës së Madhe”, “Ujësjiellësi dhe ujërat e përdorura, Shkodër dhe Koplik”, “Projekte me KfW”, “Projekte të programit IPA” dhe “Projekti i shërbimeve esenciale”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve, do të trajtohen në pagë, si më poshtë vijon:

- Drejtuesi i projektit (Koordinatori) barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-a, në ministri.

- Specialistët barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë III-b, në ministri.

Përfshirja deri në datën 1 gusht 2013, vlerat e pagave për kategoritë II-a dhe III-b, me të cilat do të trajtohen këta punonjës, të jenë sipas vendimit nr. 524, datë 16.8.2012 të Këshillit të Ministrave.

ç) Në lidhjen I/1 “Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë për punonjësit mbështetës në administratën e ministrive të linjës, institucioneve të pavarura e kushtetuese, institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, të përmendur në pikën 4, bëhen ndryshimet e shtesat e mëposhtme:

- Në klasën IV shtohet emërtesa “punëtor mirëmbajtjeje”;

- Në klasën III emërtesa “punëtor mirëmbajtës” shfuqizohet;

- Në klasën VIII, emërtesat “bibliotekar në ministritë e linjës” dhe “ndihmësinsektor”, shfuqizohen.

2. Emërtesa “ndihmësspecialist” të vazhdojë të jetë pjesë e lidhjeve përkatëse të këtij vendimi, deri më 31 dhjetor 2013.

3. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore të përballohen:

- nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për politikën e pagave për vitin 2013, për efekt të rritjes së pagave për çdo klasë, dhe do të fillojnë nga data 1 gusht 2013.

- nga fondet e miratuara për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit për efekt të parashikimit të pikës 19/1.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 gusht 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. I

**NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT,
KUVENDIT, NË KRYEMINISTRI, INSTITUCIONE TË PAVARURA, APARATET E
MINISTRIVE TË LINJËS, INSTITUCIONE QENDRORE NË VARËSI TË
KRYEMINISTRIT/MINISTRAVE TË LINJËS DHE NË PREFEKTURA**

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	I	22000
2	II	23750
3	III	25000
4	IV	25650
5	V	26800
6	VI	28900
7	VII	30500
8	VIII	33600
9	IX	36500
10	X	38000

Lidhja nr. II

NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË INSTITUCIONET RAJONALE DHE VENDORE

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	I	22000
2	II	23750
3	III	25000
4	IV	25650
5	V	26800
6	VI	27800
7	VII	28400
8	VIII	29200
9	IX	30200
10	X	31700
11	XI	32000
12	XII	34000
13	XIII	35000
14	XIV	36500



VENDIM
Nr. 611, datë 24.7.2013

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.590, DATË 5.9.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR CAKTIMIN E BANESAVE TË PERSONALITETEVE TË LARTA
SHTETËRORE TË VENDIT, TË SELIVE, REZIDENCAVE DHE OBJEKTEVE TË TJERA
SHTETËRORE, QË DO TË RUHEN DHE MBROHEN NGA GARDA E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d” të nenit 4 të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shkronjën “a” të pikës 1 të vendimit nr. 590, datë 5.9.2007 të Këshillit të Ministrave, pas emërimit “... - Ministrit të Brendshëm...” shtohet “...- drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 613, datë 24.7.2013

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT TË FORMËS “ROT”
(REHABILITIM, OPERIM, TRANSFERIM), TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË
EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “KURUM
INTERNATIONAL” SHA, PËR REHABILITIMIN E RAFINERISË SË CËRRIKUT,
RRETHI ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit të formës “ROT” (rehabilitim, operim, transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Kurum International” sh.a., për rehabilitimin e rafinerisë së Cërrikut, rrethi Elbasan, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KONTRATË KONCESIONI
E FORMËS “ROT” (REHABILITIM, OPERIM, TRANSFERIM) PËR
REHABILITIMIN E RAFINERISË SË CËRRIKUT, RRETHI ELBASAN

Në Tiranë, në datë 22 korrik, viti 2013 (dy mijë e trembëdhjetë), para meje, noter Rudina Hoxhaj, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën palët kontartkuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që më poshtë do të quhet **“AUTORITET KONTRAKTUES”**, përcaktuar si i tillë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 23/01/2013, “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues, për dhënien me koncension të “Rafinerisë së Cërrikut”, dhe miratimin e bonusit ne procedurën perzgjedhese konkurruese që i jepet shoqërisë”, përfaqësuar nga Z. Florjon Mima, shtetas shqiptar, i datëlindjes 02.05.1962, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga ID 024394597.

DHE

Shoqërisë Tregtare “Kurum International” sha, që në vijim do të quhet **“KONCESIONARI”**.

Shoqëria “Kurum International” sha, e cila figuron e regjistruar si person juridik ne QKR me NIPT K02727230T dhe datë 07/07/2000 regjistrimi, përfaqësohet nga Administratori i Përgjithshëm Z Koray Zeytinoglu, shtetas shqiptar, i datëlindjes 17.06.1977, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta nr. BC6836929.



Hyrje

Duke patur parasysh se:

Qeveria e Shqipërisë:

1. I ka dhënë një rol prioritar prodhimit të nën-produkteve të naftës bruto nëpërmjet ndërtimit të rafinerive të reja ose rehabilitimit të rafinerive ekzistues me anë të procedurave të koncesionit, për përmirësimin e treguesve teknikë dhe ekonomikë të sektorit të hidrokarbureve kombëtar;
2. Konsideron ndërtimin dhe rehabilitimin e rafinerive të prodhimit të nën-produkteve të naftës bruto si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të hidrokarbureve.
3. Vlerëson formën “ROT” të koncesionit, si një formë koncesioni që bën të mundur nxitjen e investitorëve privatë për rehabilitimin e rafinerive të përpunimit të naftës bruto me anën e kapitalit privat;
4. Është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të hidrokarbureve brenda dhe jashtë vendit;
5. Mirëpret investitorët vendas ose të huaj në krijimin e kapaciteteve të reja prodhuese të nën-produkteve të naftës bruto.

Koncesionari:

1. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, për rehabilitimin dhe operimin e rafinerisë të sipërpërmendur, dhe në përfundim të procedurës përzgjedhëse konkurruese është vlerësuar si ofertuesi më i mirë.
2. Është i interesuar të investojë në rehabilitimin e ‘Rafineria e Cërrikut’, rrethi Elbasan, me qëllim përpunimin e naftës bruto dhe prodhimin e nën-produkteve të naftës;
3. Zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiarë, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektit të kësaj marrëveshje;
4. Zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Palët lidhin këtë kontratë koncesioni bazuar në Ligjin nr.9663 dt.18.12.2006 “Për koncesionet” i ndryshuar, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 23/01/2013, “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues, për dhënien me koncension të

“Rafinerisë së Cërrikut”, dhe miratimin e bonusit ne proceduren perzgjedhese konkuruese qe i jepet shoqerise”, dhe bien dakord për sa më poshtë:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizime dhe interpretime

1. Kudo që në këtë Kontratë përdoren termat e mëposhtëme, ato do të kenë kuptimet përkatëse si vijon:
 - 1.1. **Kontrata e Koncesionit** : Kjo kontratë, anekset dhe çdo dokument tjetër që do të bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.
 - 1.2. **Ligji “Për Koncesionet”**: Ligji nr.9663, datë 18.12.2006 “Per koncesionet”, i ndryshuar.
 - 1.3. **Autoriteti Kontraktues**: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 - 1.4. **Koncesionari**: Shoqëria ‘Kurum International’ sh.a, me seli me adrese: Kombinati Metarulgjik, Komuna Bradashesh, Elbasan.
 - 1.5. **Rafineri**: Rafineria e Cërrikut, me vendndodhje në Cërrik, rrethi Elbasan, e përbërë nga tërësia e objekteve dhe impianteve që shërbejnë për përpunimin e naftës bruto.
 - 1.6. **Vepra dhe Territori**: Rafineria e Cërrikut sipas përkufizimit të mësipërm dhe territori fizik që e kufizon atë.
 - 1.7. **Objekti**: Financimi, projektimi, rehabilitimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajta e rafinerisë dhe transferimi i saj nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
 - 1.8. **Investimi**: Vlera totale në lekë që do të shërbejë për rehabilitimin dhe paisjen me makineritë e nevojshme të rafinerisë, deri në fillimin e prodhimit të nën-produkteve të naftës bruto.
 - 1.9. **Punimet**: Tërësia e veprimeve për projektimin inxhinierik/teknik, rehabilitimin/ndërtimin dhe vënien në punë të objektit “Rafineria e Cërrikut”, në përputhje me projektin e zbatimit.
 - 1.10. **Fillimi i punimeve**: Zbatimi i projektit pas miratimit të tij sipas nenit 6 të kësaj kontrate.
 - 1.11. **Vënia në punë e rafinerisë**: Fillimi i prodhimit të nën-produkteve të naftës bruto pas testimit sipas nenit 9 të kësaj kontrate.



- 1.12. **Kontratat:** Të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari, me sipërmarrësit për realizimin e punimeve ose çdo marrëveshje tjetër e lidhur me të tretët që ka si objekt operimin e rafinerisë dhe/ose sigurimin e fondeve financiare.
- 1.13. **Leje dhe Liçenca:** Akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatës publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, bazuar në legjislacionin në fuqi.
- 1.14. **Operimi:** Të gjitha veprimet e koncesionarit për prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e nën-produkteve të naftës bruto, në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.
- 1.15. **Tarifa koncesionare:** Sasia vjetore e kapacitetit përpunues e shprehur në përqindje, që i jepet pa pagesë Autoritetit Kontraktues.
- 1.16. **Llogaritja e afateve:** Kur afati është caktuar me ditë, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.
- 1.17. **Data Efektive:** Nënkupton datën në të cilën kjo Kontratë nënshkruhet nga palët dhe hynë në fuqi sipas legjislacionit përkatës.
- 1.18. **Sigurimi i kontratës:** Detyrimi në vlerë monetare i garantuar nga një shoqëri sigurimesh ose institucion financiar bankar, me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së kontratës nga Koncesionari, sipas nenit 13.
- 1.19. **Ligj:** Nënkupton çdo ligj organik, dekret, vendim të Këshillit të Ministrave ose çdo ligj tjetër që shpallet si i tillë, rregullore, udhëzim, urdhër, licensë, leje, autorizim ose çdo akt tjetër ligjor i shpallur nga Republika e Shqipërisë, vendime gjyqësore që kanë karakter unifikues, akte zyrtare të lëshuara nga çdo organ qëndror dhe/ose vendor, ashtu siç mund të ndryshojnë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.
- 1.20. **Aneks:** Çdo deklaratë, vërtetim, autorizim, vendim, urdhër ose dokument tjetër i nënshkruar nga palët që i bashkëlidhet kësaj Kontrate, si pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj, tani apo në të ardhmen.
- 1.21. **Instrument Financiar:** Nënkupton çdo marrëveshje huaje, kredie, marrëveshje siguruese ose çdo instrument tjetër i përdorur nga Koncesionari në lidhje me financimin e objektit të këtij koncesioni, duke përfshirë çdo ndryshim, shtesë, rinovim apo zëvendësim të secilit prej këtyre instrumenteve.

- 1.22. **Pala Financuese:** Nënkupton institucionet financiare të liçencuara si të tilla ose persona juridik me status të ndryshëm nga ai i institucionit financiar, që do të ndihmojë Koncesionarin në financimin e objektit të koncesionit.
- 1.23. **“Gëzim i qetë”** do të thotë e drejta ekskluzive për të zënë, përdorur dhe gëzuar Objektivin së bashku me Territorin rrethues të koncesionit (duke përfshirë Objektet Ekzistuese) dhe të Drejtën për Kalim gjatë Afatit, në përputhje me këtë Marrëveshje, pa ndërhyrje të parregullt nga Autoriteti Kontraktues ose nga ndonjë Enti Shtetëror.
- 1.24. Përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe, në këtë Kontratë:
- 1.24.1. Njëjësi e përfshin shumësin dhe anasjelltas;
- 1.24.2. Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjansë;
- 1.24.3. Çdo frazë që fillon me fjalët "duke përfshirë", "përfshin", "në veçanti", "për shembull", "të tilla si apo të ngjashme, do të kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;
- 1.24.4. Titujt e përdorur për nenet, paragrafet, nënparagrafet, Anekset dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate;
- 1.24.5. Referimet në dispozitat dhe Anekset janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat dhe anekset e kësaj Kontrate.
- 1.24.6. Pa paragjykim ndaj paragrafit të mësipërm, nëse ka ndonjë konflikt apo mospërputhje ndërmjet dispozitave dhe Anekseve dhe/ose ndonjë shtojcë të Anekseve dhe/ose çdo dokumenti tjetër që i referohemi në këtë Kontratë, konflikti apo mospërputhja do të zgjidhet sipas:
- i. Dokumenteve Standarte të Procedures Konkurruese;
 - ii. Oferta e Koncesionarit;
 - iii. Dispozitave të kësaj kontrate si dhe cdo Aneks tjetër dhe/ose shtojcat e tyre bashkelidhur saj.

Neni 2

Objekti i Koncesionit

Me anë të kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në bazë të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Per koncesionet”, i ndryshuar, i jep Koncesionarit me koncesion të formës ROT (që do të thotë rehabilitim, operim dhe transferim i së drejtës së pronësisë dhe operimit, në përfundim të kontratës së koncesionit):



Financimin, projektimin, rehabilitimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajten e objektit “Rafineria e Cërrikut” dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Parametrat tekniko-ekonomik të kësaj vepre janë:

- a) Kapaciteti i përpunimit të naftës bruto është 500 000 (pesëqind mijë) ton në vit
- b) Numri i impianteve teknologjike, si tregues i shkallës së përpunimit të lloshmërisë së produkteve të gatshëm të rafinimit sipas standardeve dhe kushteve teknike në fuqi, është 14 (katërmëdhjetë impiante)
- c) Skema e furnizimit dhe shpërndarjes së naftës, gazit dhe nënprodukteve të prodhuar nga rafineria është me rrugë hekurudhore
- d) Koha e zbatimit të punimeve është 18 muaj, sipas grafikut të punimeve në Aneksin II bashkëlidhur kësaj kontrate.
- e) Vlera e investimit (pa TVSH) është 6 769 899 144 (gjashtë miliardë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë million e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dyzet e katër lekë)
- f) Vlera e “Fee Koncesionare”, e shprehur në % të kapacitetit vjetor përpunues, është 4% (katër përqind)

Neni 3

Periudha e Koncesionit

- 3.1. Koncesioni jepet për një periudhë prej 35 (tridhjetepesë) vjetësh nga Data Efektive dhe përfundon në ditën e përvjetorit të 35-të të Datës Efektive (“Periudha Efektive”).
- 3.2. Në rastin e Zgjidhjes përpara afatit 35 vjeçar, Periudha e Koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet tek periudha që fillon nga Data Efektive dhe mbaron në Datën e Zgjidhjes.
- 3.3. Rastet e zgjatjes së Periudhës së Koncesionit:
 - 3.3.1 Palët bien dakord se për shkaqe që ndikojnë drejtpërdrejt në Projekt (jo të shkaktuara nga Koncesionari) Periudha e Koncesionit do të shtyhet, në përputhje me kohën e duhur që projekti të konsiderohet si rentabël dhe financiarisht i përshtatshëm në përputhje me analizat financiare të “Vlerës Aktuale Neto”, “IRR” apo çdo lloj analize tjetër të përshtatshme për vlerësime të tilla.
 - 3.3.2 Palët bien dakord se Periudha e Koncesionit do të shtyhet në rastin e një Ngjarjeje të Forcës Madhore, për një periudhë kohe të barabartë me kohën që ka zgjatur Ngjarja dhe kohën e arsyeshme që nevojitet për riparimin e dëmeve të shkaktuara, me kusht që vetë Ngjarja të ketë zgjatur një periudhë kohe që e kalon 1 (një) muaj.

KREU II

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Neni 4

Të drejtat koncesionare – Objekti dhe Territori

4.1. Dhënia e të Drejtave Koncesionare

Që në Datën e Hyrjes në Fuqi, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit, i cili i pranon të drejtat ekskluzive për të gjithë Afatin:

- i. të projektojë, financojë, rehabilitojë, testojë, të ketë në pronësi, të operojë dhe të mirëmbajë Kompleksin e objekteve të rafinerisë dhe territorin përkatës;
- ii. në varësi të Nenit 5.2 më poshtë, të ketë Gëzim të Qetë;
- iii. me mbarimin e Afatit Koncesionari t'i kthejë sërish Autoritetit Kontraktues Kompleksin e Objekteve të Rafinerisë dhe të Drejtën për Kalim, dhe t'i transferojë Autoritetit pronësinë e Kompleksit të Rafinerisë (ku përfshihen Objektet Ekzistuese dhe Objektet e Shtuara, nese ka); si dhe, në çdo rast, t'i kryejë ato veprime, të cilat janë pazgjidhmërisht të lidhura me këto aktivitete (së bashku, “**të Drejtat Koncesionare**”).
- iv. Koncesionari do të ketë të drejtën ekskluzive ndaj çdo atributi mjedisor që mund të gjenerohet nga Projekti.

Neni 5

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

- 5.1. Të sigurojë vazhdimësinë e kësaj kontrate pavarësisht ndryshimeve të objektivave të Sektorit të Hidrokarbureve.
- 5.2. Autoriteti Kontraktues me kërkesë të Koncesionarit merr përsipër të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar këtë të fundit tek organet shtetërore për çdo pengesë që mund të haset në kuadër të pajisjes me leje, licensa, autorizime apo çdo lloj tjetër leje që nevojitet për ekzekutimin e punimeve dhe operimin e kësaj vepre. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm kur mospajisja me leje, licensë, autorizim, etj, vjen si rezultat i mospërbushjes së kërkesave ligjore përkatëse për shkak të Koncesionarit.



- 5.3 Të miratojë projektin e Zbatimit të rafinerisë, të përgatitur nga vetë Koncesionari, në përputhje me propozimin për të cilin është shpallur fitues në procedurën e garës.
- 5.4 Të ndihmojë Koncesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të objektit të kësaj kontrate.
- 5.5 Te asistojë Koncesionarin, nese kërkohet nga ky i fundit, të lidhë një kontratë në përputhje me legjislacionin në fuqi, me subjektet juridike të furnizimit me lëndë të parë të nevojshme për vënien në punë me kapacitet të plotë të veprës.
- 5.6 Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për detyrimet ligjore dhe kontraktore në rast të mospërbushjes së këtyre detyrimeve nga ana e tij duke shpërblyer të gjitha dëmet e shkaktuara Koncesionarit për shkak të shkeljes së Kushteve të përcaktuara në kontratën e koncesionit.

KREU III

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT

Neni 6

Detyrimet e Koncesionarit

- 6.1 Koncesionari është i detyruar të zbatojë Projektin dhe objektin e Kontratës konform termave dhe kushteve të saj.
Veçanërisht Koncesionari duhet që:
 - 6.1.1 Të themelojë brenda 30 ditësh nga hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit, shoqërinë koncesionare, që do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.
 - 6.1.2 Me krijimin e shoqërisë së re koncesionare, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me këtë kontratë do të transferohen nga Koncesionari tek Shoqëria Koncesionare duke filluar që nga data e regjistrimit të Shoqërisë Koncesionare në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
 - 6.1.3 Koncesionari dhe shoqëria e re e krijuar do të jenë solidarisht përgjegjës për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë kontratë.
 - 6.1.4 Një kopje e aktit të themelimit, statutit dhe regjistrimit të shoqërisë së re si person juridik, do të dorëzohet Autoritetit Kontraktues brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e regjistrimit, për të marrë miratimin e këtij të fundit, duke patur parasysh që miratimi i këtij të fundit të jepet brenda 30(tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së dokumentit përkatës. Në rast vonese për shprehjen e miratimit, konsiderohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka vërejtje

apo sugjerime në lidhje me themelimin e personit të ri juridik. Në mënyrë të veçantë kërkoher që në përmbajtjen e Statutit të përfshihen të paktën:

- i. Forma e shoqërisë: Forma e shoqërisë do të jetë “shoqëri aksionere”, duke funksionuar në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
 - ii. Objekti i shoqërisë: Rehabilitimi, operimi dhe transferimi i “Rafinerisë së Cërrikut”, tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, rehabilitimi, vënia në punë, përpunimi, prodhimi, shitja, e produkteve hidrokarbure, në zbatim të kësaj Kontrate Koncesioni. (Nuk lejohet asnjë lloj tjetër veprimtarie tregtare përveç atyre që ushtrohen në kuadër të kësaj Kontrate);
 - iii. Kohëzgjatja: Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me afatin e kësaj Kontrate Koncesioni;
 - iv. Themeluesi i shoqërisë: Shoqëria e re do të themelohet vetem nga Koncesionari.
- 6.1.5 Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues, për miratim projektin e zbatimit, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.
- 6.1.6 Të aplikojë brenda 12 muajve nga data e miratimit të projektit të zbatimit për pajisjen me të gjitha lejet dhe licensat e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 6.1.7 Të zbatojë preventivin e paraqitur sipas Aneksit 1 bashkëlidhur kontratës;
- 6.1.8 Të marrë masa që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuar dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë;
- 6.1.9 Të administrojë projektin për periudhën e koncesionit;
- 6.1.10 Të kërkojë nëse e gjykon me interes dhe të përshtatshme, zbatimin e detyrimit të Autoritetit Kontraktues sipas nenit 5, më sipër.
- 6.1.11 Të parandalojë dhe kontrollojë çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë punim i tij dhe te ktheje ambientin, me shpenzimet e veta, në situatën e mëparshme (para ndotjes).
- 6.1.12 Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
- 6.1.13 Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.
- 6.1.14 Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;

Neni 7

Vlerësimi i Investimeve



- 7.1. Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 6 769 899 144 (gjashtë miliard e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë, sipas Aneksit nr. 1 bashkëlidhur, nga të cilat 5 921 646 114 (pesë miliard e nëntëqind e njëzet e një milion e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e njëqind e katërmëdhjetë) lekë do të investohen në makineri e pajisje.
- 7.2. Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:
- pas variantit përfundimtar të projektzbatimit i cili mund të permiresohet por duke ruajtur të pandryshuar termit e percaktuara në këtë marrëveshje.
 - në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në reabilitimin e veprës;
- 7.3. Vlera e ndryshuar e investimit mund të jetë më e madhe se 338,494,957 (treqind e tridhjetë e tetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë plus vlerën e parashikuar në nenin 2 të kësaj kontrate, por jo më e vogël se vlerën e parashikuar në nenin 2 të kësaj kontrate minus 338,494,957 (treqind e tridhjetë e tetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë, ku vlera prej 338,494,957 (treqind e tridhjetë e tetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë përfaqëson një ndryshim të investimit në masën 5% (pesë përqind) të investimit total të parashikuar në nenin 2 të kësaj kontrate.
- 7.4. Në rast mosrespektimi të vlerës totale të investimit të parashikuar në nenin 2 të kësaj Kontrate, por brenda parametrave të lejueshëm të ndryshimit të parashikuar në pikë 3 të këtij neni, Koncesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të përfunduara, ku vlerë totale do të merret kufiri më i ulët i lejuar.

Neni 8

Programi punimeve

- 8.1. Koha e zbatimit të punimeve është 18 muaj, sipas grafikut të punimeve në Aneksin II bashkëlidhur kësaj kontrate.
- 8.2. Këto afate do të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre, jo për faj të koncesionarit. Koha e shtyrjes do të jetë sa koha e vonësve të krijuara nga subjektet shtetërore.

Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate, për shkak të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 2 të nenit 8, në përfundim të periudhës të parashikuar në këtë nen, penalizon Koncesionarin: Për shkelje të afatit të reabilitimit dhe ndërtimit Koncesionari penalizohet me 0,2 % në muaj të vlerës së investimeve të munguara.

Neni 9

Testimi i veprës

- 9.1. Në përfundim të punimeve, duhet të kryhet testimi i veprës, për të siguruar funksionimin e rafinerisë. Testimi do të fillojë brenda 30 (tridhjetë) ditë pune nga marrja e njoftimit të bërë nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
- 9.2. Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Koncesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të rafinerisë, brenda 30 ditëve nga fillimi i testimit, duke patur parasysh kompleksitetin e veprës.
- 9.3. Në rast mospjesëmarrjeje të Autoritetit Kontraktues gjatë testimit, Koncesionari ka të drejtë të kryejë vetë testimin dhe vënien në punë të veprës, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues me shkrim, brenda 30 ditëve nga testimi dhe vënia në punë.
- 9.4. Në rast se testimi konkludohet jo plotësisht i sukseshëm, Koncesionari ka të drejtën e shtyrjes së vënies në punë të rafinerisë për një periudhë kohe të rënë dakord me grupin e testimit, kohë e nevojshme për përmirësimin e veprës.

Neni 10

Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit

- 10.1. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë kontratën:

- 10.1.1. Kur Koncesionari nuk zbaton në mënyrë të përsëritur detyrimet e tij të parashikuara në këtë Kontratë, për paaftësi apo neglizhencë të Koncesionarit.
- 10.1.2. Kur nuk siguron fillimin e financimit të projektit brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kontratës.

- 10.2. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Koncesionari:

Koncesionari, ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë kur Autoriteti Kontraktues është në shkelje serioze të detyrimeve të tij kontraktore dhe nuk e korrigjon këtë shkelje.

- 10.2.1. Vazhdimi i saj behet i pamundur jo për faj të koncesionarit.
- 10.2.2. Në rastet e parashikuara nga neni 17 pika 3 e kësaj kontrate.

- 10.3. Njoftimi i zgjidhjes së kontratës

Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e kësaj Kontrate në përputhje me këtë nen, do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër. Njoftimi duhet të përmbajë:

- i. Detajet e duhura duke nënvizuar shkakun e zgjidhjes;



- ii. Datën e përfundimit të kontratës, në rast të moskorrigjimit të shkeljes brenda 30 ditëve nga data e njoftimit;
- iii. Hollësitë e llogaritjes së pagesave si rezultat i zgjidhjes së kontratës;
- iv. Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

10.4. Zgjidhja e kontratës me konsensus:

Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm, duke negociuar mënyrën e kompensimit të investimit. Gjithësesi, Koncesionari ka të drejtë të kërkojë Sigurimin e Kontratës nëse ekziston.

10.5. Të Drejtat e Palëve Financuese dhe zëvendësimi i koncesionarit:

10.5.1. Njoftimi i Palëve Financuese:

Menjëherë pas marrjes dijeni për shkelje serioze nga ana e koncesionarit të detyrimeve kontraktore, që çenojnë zbatimin dhe operimin e koncesionit ose sjellin si pasojë zgjidhjen e kontratës sipas pikave 10.1.1, 10.1.2, të kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues përveç njoftimit të koncesionarit sipas pikës 10.1 të këtij neni, njofton edhe Palën Financuese me qëllim dhënien e një mundësie, kësaj të fundit, për të ndihmuar koncesionarin për të korrigjuar ose marrë masa për të rregulluar këto shkelje brenda 60 (gjashtëdhjete) ditësh nga data e një njoftimi të tillë. Autoriteti Kontraktues i jep Palës Financuese ndihmesë të arsyeshme për këtë qëllim.

10.5.2. Zëvendësimi i Koncesionarit

Në rast se nuk është bërë i mundur korrigjimi i shkeljes nga koncesionari, Pala Financuese (nëse e gjykon me interes) zgjedh, të ndërhyjë duke i propozuar Autoritetit Kontraktues, transferimin e Projektit në duart e një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues i cili duhet që të ketë, ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjëndjen financiare të paktën të barazvlershme me atë të Koncesionarit në momentin e fitimit të gares;

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues nuk do të pengojë apo vonojë pa arsye, pëlqimin e tij dhe do të bëjë ato veprime që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash në lidhje me Palët Kontraktuese.

Zëvendësuesi, do të ketë të drejtën e menaxhimit/administrimit të projektit dhe do të realizojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e koncesionarit.

10.5.3. Nëse Pala Financuese vendos të mos ushtrojë të drejtat e parashikuara në këtë nen, ose nëse edhe pas ushtrimit të këtyre të drejtave nuk arrihet në një zgjidhje të arsyeshme për vashdimësinë e projektit, kontrata do të zgjidhet.

10.6. Pagesat në rast zgjidhjeje të Kontratës:

10.6.1. Ne rast te zgjidhjes se Kontrates per faj te Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues nuk merr persiper asnje detyrim per pagesa ndaj Koncesionarit. Ne rast se kjo kontrate zgjidhet ne rastin kur shoqeria Koncesionare eshte ne proces falimentimi dhe/ose likuidimi per faj te koncesionarit, Autoriteti Kontraktor ka te drejten te marre vleren e sigurimit te Kontrates.

10.6.2. Pagesat e zgjidhjes se kontrates nga Koncesionari per faj te Autoritetit Kontraktues.

Në rast të zgjidhjes së kontratës për faj të Autoritetit Kontraktues apo pengesave institucionale të lindura nga institucionet shtetërore që vështirësojnë vazhdimësinë e operimit të veprës, ky i fundit duhet t'i paguajë koncesionarit, vlerën e investimit të kryer, fitimin e munguar nga momenti i zgjidhjes së kontratë deri në përfundimin e periudhës koncensionare të vendosur ndërmjet palëve në momentin e nënshkrimit të kontratës, si dhe cdo dëm tjetër moral dhe emri të mirë të shkaktuar ndaj koncesionarit për shkak të zgjidhjes së kësaj kontrate, të vlerësuar nga një palë e tretë, ne cdo rast efektet e zgjidhjes se kontrates sipas pikes 10.6.2 do te trajtohen ne perputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar ne fuqi, ne menyre te vecante sipas dispozitave te Kodit Civil, nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 11

Kontratat

- 11.1. Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të projektit dhe cdo lloj kontratë tjetër, me qëllim realizimin e objektit të koncesionit. Në të gjitha kontratat, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate koncesioni.
- 11.2. Koncesionari është përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktues, për përmbushjen e detyrimeve nga ana e nënkontraktuesit.
- 11.3. Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

Neni 12

Monitorimi dhe Raportimi

- 12.1. Konkensionari raporton mbi ecurinë e punimeve të rehabilitimit dhe ndërtimit të veprës cdo tre muaj gjatë periudhës së parashikuar për ndërtimin e veprës.
- 12.2. Duke filluar nga data kur vepra vihet në punë dhe deri në përfundim të kësaj kontrate koncensionari raporton pranë Entit Shtetëror përgjegjës për këtë kontratë cdo fund viti kalendarik, por jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.



Neni 13

Sigurimi i kontratës

- 13.1. Koncesionari, para nënshkrimit të kontratës, duhet të ketë siguruar nga një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, garancinë për shumën prej 676,989,914 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë) lekë, që përbën 10 % (dhjetë përqind) të vlerës totale të investimit. Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkëlidhet kësaj kontrate.
- 13.2. Koncesionarit i lejohet të ç'ngurtësojë këtë vlerë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga kryerja e testimit të veprës dhe vënia në punë.
- 13.3. Sigurimi i Kontrates do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, të detyrimeve të Koncesionarit në lidhje me përfundimin e punimeve të rehabilitimit dhe përfundimin e testimit.

Neni 14

Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit

14.1. Tarifa koncesionare

Koncesionari duhet të paguaje për llogari të Autoritetit Kontraktues një tarife koncesionare të barabartë me vlerën e 4 % (katër përqind) të kapacitetit përpunues, si dhe të çdo përfitimi tjetër që Koncesionari do të ketë, në raport të drejtë me përqindjen që përfaqëson tarifën koncesionare, nga prodhimi i nën-produkteve të naftës bruto, duke përfshirë por pa u limituar në të drejtat që rrjedhin nga reduktimi i karbonit dhe gazrave të tjerë në atmosferë.

Kjo tarifë nuk do të jetë objekt ndryshimesh deri në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit.

14.2. Vlera e riinvestimit

Duke filluar nga viti i 25-të nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, Koncesionari do të riinvestojë 60 % (gjashtëdhjetë përqind) të vlerës së investimit për makineri dhe pajisje, sipas një grafiku që do të hartohet nga palët për këtë qëllim, jo më vonë se viti i 23-të nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate.

Neni 15

Kufizimet

- 15.1 Për çdo transferim të aksioneve/të kapitalit themeltar të saj tek të tretët Koncesionari ose shoqëria e re koncesionare duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Në këtë rast pales se trete do ti transferohen dhe detyrimet apo te drejtat e percaktuara ne kontraten e koncesionit.

- 15.2 Koncesionari nuk ka të drejtë të nënkontraktojë asnjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, për vlera me të mëdha se 50 % të vlerës së investimit, pa marrë miratimin paraprak, me shkrim, të Autoritetit Kontraktues. Për mënjanimin e ndonjë keqkuptimi furnizuesit e pajisjeve, materialeve dhe/ose dërgesave nuk do të konsiderohen nënkontraktore sipas kësaj Kontrate.
- 15.3 Shoqëria e re që do të krijohet, sipas nenit 6, dhe/ose Koncesionari ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet që do të krijohen (jo mbi ato ekzistuese) në zbatim të projektit të punimeve si dhe të lidhë çdo lloj marrëveshje financimi me çdo Palë Financuese, me kusht që hipoteka, pengu apo barra tjetër si dhe marrëveshja përkatëse e financimit t'i shërbejë përmbushjes së detyrimeve të Koncesionarit në këtë Kontratë.

Neni 16

Legjislacioni i zbatueshem

- 16.1. Lidhja, zbatimi dhe interpretimi i kësaj Kontrate Koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar.

Neni 17

Forca Madhore

- 17.1. Konsiderohen Ngjarje të Forcës Madhore:
- Katastrofat e natyrës, përmytjet, tërmetet, ndotje nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to;
 - Lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, bllokada, embargo- që zgjasin për një kohë jo më të vogël se një muaj;
- 17.2. Në rastet e Forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 30 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e përmbushjes së detyrimeve në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.
- Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore. Kufijtë dhe afatet e përmbushjes së detyrimeve në një rast të tillë, do të përcaktohen nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre.
- Periudha e koncesionit do të zgjatet në përputhje me nenin 3 të kësaj kontrate.
- 17.3. Zgjidhja e kontratës për shkak të forcës madhore
- Pala e prekur nga forca madhore ka të drejtë të zgjidhë kontratën e koncesionit:



- iii. në rast se edhe pas zbatimit të pikës 17.2 të këtij neni, nuk është arritur një zgjidhje në të mirë të projektit,
 - iv. kur forca madhore zgjat më tepër se 1 muaj.
- 17.4. Pasojat e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore
- Në rastet e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore, palet nuk kanë detyrime ndaj njera tjetrës dhe secila palë do të perballojë kostot e veta.
- 17.5. Zgjidhja e mosmarreveshje që vijnë si pasojë e forcës madhore do të bëhet në përputhje me nenin 19 të kësaj kontrate.

Neni 18

Hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit

- 18.1. Kontrata e Koncesionit do të hyjë në fuqi pasi të nënshkruhet nga palët, në përputhje me Ligjin Nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, i ndryshuar dhe miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave.

Neni 19

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 19.1. Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.
- 19.2. Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Koncesioni, do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.
- 19.3. Fillimi apo vazhdimi i procedurave për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Koncesioni, nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës, vec nëse Gjykata kompetente nuk vendos të kundërtën.
- 19.4. Fillimi apo vazhdimi i procedurave për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Koncesioni, dhe nuk do të çlirojë asnjë nga palet nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate.

Neni 20

Rregullimi i shkeljeve

- 20.1. Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë periudhës së koncesionit, Koncesionari ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të permendura në këtë kontratë, ai menjehere ia bën të njohura këto shkelje Koncesionarit duke pritur për një periudhë 30 ditore përgjigjen e tij, me argumentat përkatëse. Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.

Neni 21

Transferimi i Aseteve

- 21.1. Me mbarimin e kontratës, Koncesionari do të kryejë çdo veprim të nevojshëm për dorëzimin tek Autoriteti Kontraktues, të asetëve të marra në dorëzim nga ai, ato të realizuara nga Koncesionari gjatë periudhës së koncesionit si dhe çdo titull mbi to, të zhveshura nga çdo lloj detyrimi, barre apo hipoteke.

Proçesi i Dorëzimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit me një inspektim të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.

Neni 22

Mbarimi i kontratës

- 22.1. Kontrata koncesionare mbaron me përfundimin e afatit 35 vjeçar, duke patur parasysht parashikimet e nenit 3 të kësaj kontrate.
- 22.2. Mbarimi i kontratës si përfundim i afatit të saj ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

Neni 23

Konfidencialiteti

- 23.1. Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

Neni 24

Ndryshime

- 24.1. Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve dhe me miratim të Këshillit të Ministrave.



24.2. Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

Neni 25

Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet palëve, do të bëhet vetëm me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 30 (tridhjetë) ditë nga data e ndryshimit.

Për çdo ndihmë që do t'i kërkohej Autoritetit Kontraktues nga koncesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate.

Neni 26

Rregjistrimi i Kontratës

Kjo kontratë u hartua në 6 (gjashtë) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES
MINISTRIA E EKONOMISË TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Përfaqësuar nga:
Florjon Mima

KONCESIONARI
SHOQËRIA "KURUM
INTERNACIONAL" SHA
Përfaqësuar nga:
Koray Zeytinoglu

ANEKSI I

PREVENTIVI I OBJEKTIT 'NDËRTIMI I RAFINERISË SË NAFTËS, ÇËRRIK, ELBASAN'

No. Artikulli	Njesia	Sasia	Cmimi per njesi (USD)	Cmimi per njesi		
				Kosto Totale (USD)	(ALL)	Kosto Totale (ALL)
Toka			30,000	30,000	3,127,200	3,127,200
1 Shpenzime per investigim ne lidhje me terrenin	set	1	30,000	30,000	3,127,200	3,127,200
Pune Civile			5,260,000	5,260,000	548,302,400	548,302,400
2 Rregullim dhe sistemim territorial	set	1	1,410,000	1,410,000	146,978,400	146,978,400
3 Ndertime ne Ndertesa	set	1	3,850,000	3,850,000	401,324,000	401,324,000
Makineri dhe Pajisje			56,807,810	56,807,810	5,921,646,114	5,921,646,114
Njesite e Rafinerise dhe sistemi qendror	set	1	55,137,810	55,137,810	5,747,565,314	5,747,565,314
4 Impianti i distilimit të naftës së papërpunuar	set	1	4,297,800	4,297,800	448,002,672	448,002,672
5 Impianti i distilimit me Vakum	set	1	2,025,400	2,025,400	211,127,696	211,127,696
6 Reparti Katalitik Kraking (FCC)	set	1	4,841,200	4,841,200	504,646,688	504,646,688
7 Reparti i koksizimit	set	1	1,914,250	1,914,250	199,541,420	199,541,420
8 Impianti i alkilimit(Alkylation Unit)	set	1	2,297,100	2,297,100	239,449,704	239,449,704
9 Impianti i reformimit katalitik (Catalytic Reforming -Platformer)	set	1	3,408,600	3,408,600	355,312,464	355,312,464
10 Impianti i procesit të izomerizimit (Isomerization Unit)	set	1	2,568,800	2,568,800	267,771,712	267,771,712
11 Impianti i procesit të heqjes së kriprave (Desalter Unit)	set	1	706,420	706,420	73,637,221	73,637,221
12 Impianti i procesit të aminimit (Amine Unit (DEA)	set	1	1,901,900	1,901,900	198,254,056	198,254,056
13 Impianti i trajtimit me hidrogjen me 6 pjese (Hidrotreating - Unifinerin 6 parts)	set	1	7,706,400	7,706,400	803,315,136	803,315,136
14 Impianti i Sqfurit (Sulphur Unit - Claus)	set	1	2,400,840	2,400,840	250,263,562	250,263,562
15 Impianti i avullit/shperndarja (Steam Unit / Distribution)	set	1	1,363,440	1,363,440	142,124,986	142,124,986
16 Impianti i ftohjes (Cooling Unit)	set	1	978,120	978,120	101,959,229	101,959,229
17 Njësia e trajtimit të ujërave të zeza (waste water Treatment)	set	1	2,519,400	2,519,400	262,622,256	262,622,256
18 Ngarkim/shkarkimi i cisternave (Tanker Loading/Unloading)	set	1	839,800	839,800	87,540,752	87,540,752
19 Njësia e depozitimit të naftës së papërpunuar (Crude Oil Stock Unit)	set	1	3,853,200	3,853,200	401,657,568	401,657,568
20 Njësia e depozitimit të produktit të përpunuar (Product Stock Unit)	set	1	3,556,800	3,556,800	370,760,832	370,760,832
21 Sistemi i Sigurisë	set	1	2,371,200	2,371,200	247,173,888	247,173,888
22 Sistemi i Automatizimit dhe programeve software	set	1	5,587,140	5,587,140	582,403,474	582,403,474
23 Pajisje laboratorike	set	1	670,000	670,000	69,840,800	69,840,800
24 Pajisje zyre	set	1	250,000	250,000	26,060,000	26,060,000
25 Mjete (makina etj)	set	1	750,000	750,000	78,180,000	78,180,000
Lidhja e sistemit te furnizimit me energji dhe te furnizimit me uje			2,847,500	2,847,500	296,823,400	296,823,400
26 Njesia e shperndarjes se energjise (Power Distribution Unit Transformer)	set	1	1,750,000	1,750,000		182,420,000
27 Linjat e transmetimit dhe lidhjes me energji (Transmission Line and Electricity Connection)	set	1	900,000	900,000		93,816,000
28 Sistemi i mbeshtetjes me gjenerator (Generators Power Backup)	set	1	180,000	180,000		18,763,200
29 Linja e Furnizimit me Uje	set	1	17,500	17,500		1,824,200
SHUMA PA TVSH				64,945,310		6,769,899,114
TVSH	%	20		12,989,062		1,353,979,823
SHUMA ME TVSH				77,934,372		8,123,878,937



ANEKSI II

- Grafiku i Punimeve

FAZAT		MUAJT																					
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22
Pergatitja e Projektit																							
Prodhimi	Njesia e distilimit te naftes bruto																						
	Njesia e distilimit me vakum																						
	Njesia e krakimit katalitik																						
	Koksezimi																						
	Njesia e Alkilimit																						
	Njesia e Reformimit Katalitik																						
	Njesia Izomerizimit																						
	Shkrypezimi																						
	Njesia Amine																						
	Hidrotrajtimi																						
	Njesia sulfurit																						
	Njesia e avullit																						
	Njesia e Ftohjes																						
	Njesia e trajtimit																						

	solid/likuid																		
	Ngarkim/sh karkim botes																		
	Njesia e magazinimit te naftes bruto																		
	Njesia e magazinimit te produktit																		
	Sistemi i sigurise																		
	Automatizim i & Softëare																		
Transporti																			
Montimi	Njesia e distilimit te naftes bruto																		
	Njesia e distilimit me vakum																		
	Njesia e krakimit katalitik																		
	Koksezimi																		
	Njesia e Alkilimit																		
	Njesia e Reformimit Katalitik																		
	Njesia Izomerizimit																		
	Shkrypezimi																		
	Njesia Amine																		
	Hidrotrajtim i																		
	Njesia																		

[illegible]

VENDIM

Nr. 614, datë 24.7.2013

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË TË NDJERIT SELMAN HAJREDIN
LENA, ISH- PUNONJËS POLICIE, RËNË NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e ndihmës financiare prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh familjes së të ndjerit Selman Hajredin Lena, ish-punonjës policie në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, i cili humbi jetën në krye të detyrës.
2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2013, programi “Policia e Shtetit”, miratuar për Ministrinë e Brendshme.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 615, datë 24.7.2013

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË INSPEKTOR PRENG LLESH
LLESHAJ, I PLAGOSUR NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të kurimit të inspektor Preng Llesh Lleshaj, i plagosur në krye të detyrës, në masën 3 000 000 (tre milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2013, programi “Policia e Shtetit”, miratuar për Ministrinë e Brendshme.

3. Pagesa të bëhet kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 616, datë 24.7.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT
TË Z. BESART MATAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 3 300 000 (tre milionë e treqind mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Besart Mataj.



2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 617, datë 24.7.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.997, DATË 10.12.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË PUNONJËSVE QË DËRGOHEN ME
SHËRBIM JASHTË QENDRËS SË PUNËS, BRENDË VENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 10 të ligjit nr. 119/2012, “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika I e vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“I. Punonjësit e njërive të qeverisjes së përgjithshme, të cilët gjatë ditëve zyrtare të punës shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit. Përfshihen, për punonjësit operacionalë të Policisë së Shtetit, punonjësit e Gardës së Republikës dhe punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, dërgimi me shërbim jashtë qendrës së punës nuk kufizohet me ditët zyrtare të punës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 618, datë 24.7.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.455, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT DHE SHITESAT MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË
SHËRBIMIT PYJOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Shërbimit Pyjor”, e përmendur në pikën 1 të vendimit nr. 455, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për politikën për rritjen e pagave për vitin 2013.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 gusht 2013.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT PYJOR

Nr.	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1.	I	22000
2.	II	22300
3.	III	22500
4.	IV	23000
5.	V	23300
6.	VI	23500
7.	VII	24000
8.	VIII	24300
9.	IX	24500
10.	X	25000
11.	XI	26600
12.	XII	27200
13.	XIII	27700
14.	XIV	28700
15.	XV	30900
16.	XVI	31900
17.	XVII	33700
18.	XVIII	34800
19.	XIX	35300
20.	XX	36300
21.	XXI	38000
22.	XXII	39000
23.	XXIII	41200

VENDIM

Nr. 619, datë 24.7.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 438, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 35 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”, të nenit 4/2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”, e përmendur në pikën 1 të vendimit nr. 438, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi për politikën e pagave për vitin 2013.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 gusht 2013.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Lidhja nr. 1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË
MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi
1	2	3	4
Bazë	Agjent	38000	7000
	Agjent I	41400	7000
	Asistent	44000	8000
	Asistent I	46000	8000
	Kryeasistent	48000	8000
I mesëm	Nëninspektor	52500	6000
	Inspektor	56000	6000
	Kryeinspektor	65000	6000
I lartë	Nënkomisar	74000	6000
	Komisar	85000	6000
	Kryekomisar	97000	6000
Madhor	Drejtues	108000	
	Drejtues I	118000	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 6.8.2013
Doli nga shtypi më 6.8.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 40 lekë